



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 30 tetor 2010
Nr. Ref.: AGJ 63/10

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI 06/10

VALON BISLIMI

kundër

Ministrisë së Punëve të Brendshme,

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

dhe

Ministrisë së Drejtësisë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

HYRJE

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Valon Bilsimi, nga Prishtina. Z. Feriz Gërvalla, avokat nga Prishtina, e përfaqësoi atë në këtë procedurë para Gjykatës Kushtetuese.

Palët kundërshtare

2. Palë kundërshtare në procedurën para Gjykatës Kushtetuese janë Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës.
3. Gjykata Komunale në Prishtinë mori pjesë në këtë procedurë para Gjykatës Kushtetuese dhe kishte përfaqësuesin e vet në seancën dëgjimore që u mbajt më 14 korrik 2010.

Çështja e lëndës

4. Çështje e lëndës së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së shkeljes së supozuar të lirisë së lëvizjes së parashtruesit të kërkesës të garantuar me Nenin 35 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta). Sipas parashtruesit të kërkesës, atij i është shkelur e drejta për t'u larguar nga vendi pasi i është refuzuar lëshimi i pasaportës, e cila kërkohet për të udhëtuar jashtë vendit. Parashtruesi i kërkesës më tej pohoi se në sistemin ligjor të Kosovës nuk ka mjete efektive juridike për ta ushtruar të drejtën e tij për t'u larguar nga vendi.
5. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për masa të përkohshme, përmes përfaqësuesit të vet, për ta shmangur "diskriminimin e mëtejme dhe shkeljen e të drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes me kushtëzimin e cilësdo procedurë penale në vazhdim e sipër."

Baza juridike

6. Kjo kërkesë është e bazuar në Nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, në Nenin 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Ligji), dhe në Nenin 53 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Rregullorja e punës).

Përmbledhje e fakteve

7. Më 11 nëntor 2004, Gjykata Komunale në Prishtinë mori Vendimin P. nr. 1341/04, me të cilin e konfirmonte kallëzimin penal kundër parashtruesit të kërkesës dhe katër personave të tjerë për vepër penale të vjedhjes së rëndë të përcaktuar në Nenin 253(1) 1 të Kodit të Përkohshëm Penal.
8. Gati katër vjet më vonë, në vitin 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë caktoi tri seanca dëgjimore lidhur me rastin e sipërpërmendur penal kundër parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve, më 24 qershor 2008, më 9 korrik 2008 dhe më 24 korrik 2008. Me gjithë praninë e parashtruesit të kërkesës, të gjitha seancat e caktuara ishin shtyrë për shkak të mungesës së palëve të tjera në procedurë.
9. Pas korrikut të vitit 2008, parashtruesi i kërkesës nuk ka pranuar kurrfarë thirrjeje për seancë dëgjimore lidhur me rastin e sipërpërmendur penal.
10. Më 27 prill 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për lëshimin e pasaportës në Departamentin për Prodhimin e Dokumenteve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës e bëri pagesën prej 25 eurove për pasaportë. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës as nuk e mori pasaportën, as nuk mori ndonjë vendim me shkrim me të cilin i refuzohej kërkesa e tij për pasaportë.

11. Më 13 janar 2010, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë t'ia lëshonte një certifikatë që nuk është nën hetime për ta marrë pasaportën. Ai nuk ka marrë asnjë certifikatë apo vendim të gjykatës lidhur me moslëshimin e pasaportës. Në vend të kësaj, sipas parashtruesit të kërkesës, ai mori vetëm një "refuzim verbal" për kërkesën e tij.
12. Më 28 maj 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë lëshoi aktgjykimin P. Nr. 134/04, në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve, e hodhi poshtë kallëzimin penal, dhe e pezulloi procedurën penale kundër tyre.

Ankesat e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës ankohet se i është shkelur e drejta e tij për liri të lëvizjes e garantuar me Nenin 35 (2) të Kushtetutës. Ai pohon që Gjykata Komunale në Prishtinë në mënyrë të padrejtë dhe të gabueshme i ka interpretuar dispozitat ligjore pasi ka dështuar t'ia lëshojë certifikatën, e cila, siç pohohet, është dokument i domosdoshëm për Ministrinë e Punëve të Brendshme për të lëshuar pasaportë të Republikës së Kosovës.
14. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ankohet se në Kosovë nuk ka mjete juridike që mund të përdoren për ta zgjidhur këtë situatë. Prandaj, sipas tij, ekziston nevoja për krijimin e një mekanizmi brenda shtetit për qytetarët e Kosovës që janë në të njëjtën situatë si ai për ta parandaluar shkeljen e mëtejme të së drejtës për lëshim të pasaportës.
15. Parashtruesi i kërkesës pohon që i është shkelur e drejta për liri të lëvizjes për shkak të zbatimit të gabuar të Nenit 271(2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Nenit 27.1, pika A, dhe Nenit 28.2 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit. Sipas parashtruesit të kërkesës, të dy ligjet parashikojnë që kufizimi i të drejtës për liri të lëvizjes, i shkaktuar nga refuzimi për lëshim të pasaportës, mund të vendoset vetëm për rastet në të cilat gjykata kompetente ka lëshuar vendim paraprak.
16. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon që Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka kurrfarë baze juridike për t'ia privuar të drejtën e tij kushtetuese në bazë të mungesës së certifikatës së lëshuar nga gjykata që një person nuk është nën hetime. Në parim, sipas tij, kufizimi i vendosur në të drejtën e tij për liri të lëvizjes nuk është i bazuar në ligj, por është çështje e interpretimit të gabuar të ligjeve dhe e praktikës, përfshirë këtu keqinterpretimin e një memorandumit të mirëkuptimit, të 21 gushtit 2008, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.
17. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkoi caktimin e masës së përkohshme "për të shmangur diskriminimin e mëtejme dhe shkeljen e të drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes kur kushtëzohen me ndonjë procedurë penale në zhvillim e sipër."

Komentet e palës kundërshtare

18. Në deklaratën e 24 marsit 2010 drejtuar Gjykatës, Ministria e Drejtësisë theksoi: "Edhe pse jemi nënshkrues të memorandumit të mirëkuptimit, në përputhje me dispozitat e atij memorandumit, Ministria e Drejtësisë nuk merr kurrfarë përgjegjësie konkrete lidhur me zbatimin e Nenit 27 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit". Deklarata shtonte që Ministria e Drejtësisë nuk ka kompetenca për të ndërhyrë në punën e gjyqësorit. Ministria e Drejtësisë e konfirmoi këtë pikëpamje në seancën dëgjimore të mbajtur më 14 korrik 2010.

19. Nga Ministria u kërkua të përgjigjej në këtë kërkesë, por ajo nuk dërgoi asnjë përgjigje me shkrim. Në seancën e mbajtur më 14 korrik 2010, përfaqësuesi i MPB-së theksoi se e kishin nënshkruar memorandumun e mirëkuptimit për ta lehtësuar procesin e lëshimit të pasaportave. Sipas përfaqësuesit të MPB-së, është obligim ligjor i gjykatave që ta njoftojnë organin që i lëshon pasaportat, dmth. MPB-në, për rastet në të cilat një vendim individual për refuzimin e lëshimit të pasaportës është nxjerrë. Megjithatë, ata pohojnë që gjykatat nuk lëshojnë vendime për refuzimin e lëshimit të pasaportave, ndonëse pohohet që ato janë të obliguara me ligj dhe memorandum për ta bërë atë. Sipas përfaqësuesit të MPB-së, "refuzimi i lëshimit të dokumentit të udhëtimit pa urdhër të gjykatës nuk është i drejtë".
20. Përfaqësuesi i MPB-së gjithashtu theksoi se gjykatat komunale duhet vetëm ta zbatojnë ligjin dhe se memorandum duhet ta lehtësojë punën e tyre. Në seancë u tha më tej se nëse nuk ka kurrfarë vendimi, Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'ua lëshojë pasaportat parashtruesve të kërkesës.
21. Në seancën e mbajtur më 14 korrik 2010, përfaqësuesit e MPB-së dhe të Gjykatës Komunale në Prishtinë e sqaruan praktikën e bazuar në memorandumun e mirëkuptimit me sa vijon: zyrat komunale të regjistrimit civil të MPB-së e hartojnë listën e personave që kanë paraqitur kërkesë për pasaportë dhe atë listë ia dërgojnë gjykatës. Pas marrjes së listës nga MPB-ja, gjykata i verifikon personat në dosjet e veta (d.m.th. kundër të cilëve zhvillohet procedurë penale) dhe nuk u lëshon certifikata, ndërsa personave që nuk janë në dosje, gjykata u lëshon certifikata.
22. Përfaqësuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës theksoi në seancën dëgjimore para Gjykatës Kushtetuese se gjykatat obligohen ta zbatojnë Nenin 18 të Kodit të Procedurës Penale, të cituar më poshtë. Neni 27 i Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit parashikon rastet kur gjykata mund ta ndalojë lëshimin e pasaportës. Përfaqësuesi gjithashtu shtoi që Këshilli Gjyqësor i Kosovës së shpejti do ta nxjerrë një akt të brendshëm bazuar në ligj dhe Kushtetutë, me të cilin do të kërkojë nga gjykatat që ta zbatojnë këtë ligj dhe të nxjerrin vendime për secilin rast në bazë të dispozitave përkatëse të ligjit dhe më pas ta informojnë MPB-në për kallëzimet e pazgjidhura penale dhe rastet në të cilat gjykata ndalon lëshimin e pasaportës ose urdhëron konfiskimin e pasaportës.
23. Gjykata Komunale e Prishtinës konfirmoi në një letër të 11 majit 2010 se katër seanca dëgjimore ishin caktuar për rastin e parashtruesit të kërkesës, por nuk ishin mbajtur për shkak mungesës së disa prej të akuzuarve (por jo të parashtruesit të kërkesës) dhe për shkak të mungesës së palës së dëmtuar. Si rrjedhojë, procedura ishte duke vazhduar.
24. Gjykata Komunale më tej konfirmoi se sa i përket rastit të parashtruesit të kërkesës, "Gjykata Komunale nuk ka nxjerrë dhe nuk nxjerr asnjë aktvendim të posaçëm për moslëshim të pasaportës, por nxjerr aktvendim në rastet kur pasaporta konfiskohet". Sa i përket Nenit 3 të memorandumit të mirëkuptimit, Gjykata Komunale theksoi "se e zbaton këtë marrëveshje duke pranuar grupe të kërkesave nga personat që kërkojnë lëshimin e certifikatave se kundër tyre nuk janë duke u zhvilluar procedurat penale". Për më tepër, u theksua se "në përputhje me Nenin 18 të KPP-së, gjykata fare nuk lëshon certifikatë që procedurat penale nuk janë duke u zhvilluar kur aktakuza është në fuqi, si në rastin konkret, dhe për veprën penale për të cilën parashihet gjoba ose dënimi me burg deri në tri vjet nga dita kur është marrë aktgjykimi dënues."
25. Në fund, në të njëjtën letër u sqarua se "pasi në rastin aktual nuk ishte nxjerrë asnjë vendim lidhur me personin në fjalë, nuk ka mundësi për paraqitje të ankesës".

Procedura para Gjykatës

26. Më 25 janar 2010, parashtuesi i kërkesës parashtroi kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Kryetari e caktoi Gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues, dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
27. Më 19 shkurt 2010, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi të kërkojë informata shtesë lidhur me këtë kërkesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë.
28. Më 17 mars 2010, Gjykata kërkoj informata shtesë lidhur me këtë kërkesë nga parashtuesi i kërkesës.
29. Më 28 prill 2010, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, përfshirë këtu informatat shtesë që i kishte marrë.
30. Më 16 qershor 2010, Gjykata në përbërje të plotë shqyrtoi dhe vendosi që kërkesa është e pranueshme.
31. Një seancë dëgjimore u mbajt më 14 korrik 2010. Përfaqësuesi i parashtuesit të kërkesës dhe përfaqësuesit e MPB-së, KGJK-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë ishin të pranishëm në këtë seancë. Një përfaqësues i Gjykatës Komunale të Prishtinës ishte po ashtu i pranishëm në këtë seancë.
32. Më 22 shtator 2010, Gjykata mbajti seancë të mbyllur për shqyrtim dhe e miratoi këtë aktgjykim.

Aktet përkatëse ligjore

Ligji për Dokumentet e Udhëtimit

33. Në Republikën e Kosovës, rregullat, procedurat dhe mënyra ligjore për paraqitjen e kërkesës për lëshim të dokumentit të udhëtimit dhe vlefshmëria e tyre është e rregulluar me Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit (Ligji Nr. 2008/03-L037).
34. Neni 3 i Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit e definon pasaportën me sa vijon:

“Pasaporta është dokument publik, që i jepet shtetasit të Republikës së Kosovës (në vazhdim të tekstit: shtetasi) për kalimin e kufijve shtetëror dhe për vërtetimin e identitetit dhe shtetësisë.”
35. Neni 8 i të njëjtit Ligj thotë që organ kompetent për dhënien e pasaportës është Ministria e Punëve të Brendshme.
36. Neni 23 i Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit më tutje përcakton që kërkesa për lëshimin e pasaportës bëhet në formularin e caktuar. Ai formulari kërkon këto të dhëna (shih Nenin 23.2):
 - a) emrin personal;
 - b) numrin personal të qytetarit;
 - c) datën e lindjes;
 - d) gjininë;
 - e) vendin e lindjes;
 - f) vendbanimin e përhershëm ;

- g) shtetësinë;
- h) datën dhe vendin e paraqitjes së kërkesës;
- i) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e përfaqësuesit ligjor;
- j) nënshkrimin e paraqitësit të kërkesës.”

37. Neni 26 i Ligjit në fjalë thotë që Ministria e Punëve të Brendshme duhet të vendosë lidhur me kërkesën për t’u pajisur me pasaportë brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës.

38. Neni 27 i Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit i përcakton situatat kur Ministria e Punëve të Brendshme mund ta refuzojë kërkesën për lëshimin e pasaportës me sa vijon:

“27.1 Organi kompetent , tek i cili ka qenë e paraqitur kërkesa për t’u pajisur me pasaportë e refuzon kërkesën në bazë të vendimit të gjykatës nëse:

a) kundër shtetasit , që ka bërë kërkesën për lëshimin e pasaportës është duke u zhvilluar procedurë penale respektivisht zhvillohet procedura për zgjidhjen e martesës si dhe njohjen e të drejtës prindërore, nëse gjykata kërkon ndalesën e lëshimit të pasaportës;

b) ekzistojnë interesat e mbrojtjes së shtetit, të përcaktuara në ligj;

c) shtetasit i është shqiptuar së paku dy herë dënimi me burg për veprat penale të prodhimit të kundërligjshëm dhe trafikimit të narkotikëve, falsifikim të parave, kontrabandim, falsifikim të dokumenteve, prodhim kundërligjor dhe trafikim të armëve apo eksplozivëve, kalim të kundërligjshëm të kufirit shtetëror, trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit ndërkombëtar, financimit të veprimtarisë terroriste dhe vepra tjera penale në lidhje me shtetet e huaja.

27.2 Nëse gjykata ka nxjerrë aktgjykim të plotfuqishëm kundër shtetasit të bazuar në pikat a,b,c të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të njoftojë organin kompetent mbi refuzimin e kërkesës dhe për këtë duhet të japë arsyetim.

27.3 Nëse ndonjëra nga arsyet nga pikat a,b,c, të paragrafit 1 të këtij neni, është paraqitur pas lëshimit të pasaportës, organi kompetent për dhënien e pasaportës duhet të nxjerri vendim mbi marrjen e pasaportës.

27.4 Ankesa kundër vendimit në bazë të paragrafit 3 të këtij neni, nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.”

39. Ligji për Dokumentet e Udhëtimit më tutje përcakton që gjykata kompetente është e obliguar ta lajmërojë menjëherë Ministrinë e Punëve të Brendshme nëse arsyet për refuzimin e kërkesës për t’u pajisur me pasaportë kanë pushuar (shih Nenin 28 të Ligjit).

40. Në fund, Neni 28(2) i Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit parasheh:

“Konsiderohet që nuk ka më arsye për refuzimin e kërkesës për lëshimin e pasaportës nga paragrafi 1 i nenit 27 të këtij ligji, nëse gjykata kompetente nuk e përtërin ndalesën.

Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë

41. Më 21 gusht 2008, Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë nënshkruan një memorandum të mirëkuptimit me qëllim të përcaktimit të procedurave dhe përgjegjësi ndërmjet atyre organeve në lidhje me zbatimin e Nenit 27 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit.

42. Neni 2 i memorandumit të mirëkuptimit parashikon, ndër të tjera, që:

“Menjëherë pas marrjes së aplikimit nga shtetasi/e, Zyra e Regjistrimit Civil pranë komunës e drejton kërkesën për në Gjykatën Komunale për të përcaktuar nëse në lidhje me këtë shtetas/e është duke u zhvilluar:

procedurë penale;

procedura për zgjidhjen e martesës;

procedura për njohjen e të drejtës prindërore;

ose, të konstatojë nëse ndaj shtetasi/e është shqiptuar së paku dy herë dënimi me burg për veprat penale...”

43. Neni 3 i memorandumit të sipërpërmendur, në pjesën përkatëse, thotë:

“Dërgimi i emrave që kanë aplikuar për pasaportë duhet të konsiderohet si kërkesë ndaj gjykatës për t’u shprehur me vendim nëse duhet pranuar apo jo kërkesa e shtetasit/e për t’u pajisur me pasaportë..

Në rastet kur shtetasi/e nuk është i dënuar apo nuk është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore sipas rasteve bazuar në nenin 2 më sipër, gjykata e dërgon përgjigjen brenda 1 ditë pune.

Në rastet kur shtetasi/e është i dënuar apo është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore sipas nenit 2 më sipër, gjykata lajmëron Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe qytetarin përkatës për zhvillimin e gjykimit për dhënien e vendimit në lidhje me lejimin ose jo të pajisjes me pasaportë të shtetasit/e.

Pas marrjes së vendimit, gjykata njofton Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe shtetasit përkatës brenda afatit 3 ditë pune.”

44. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, i miratuar më 6 korrik 2004, i ndryshuar më 6 nëntor 2008 nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, thotë me sa vijon:

Neni 18

Kur dihet se fillimi i procedurës penale ka për pasojë kufizimin e disa të drejtave të caktuara, këto pasoja hyjnë në fuqi nga momenti i hyrjes në fuqi të aktakuzës po qe se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ndërsa për veprat penale për të cilat është paraparë gjobë ose dënim me burgim deri në tre vjet këto hyjnë në fuqi nga dita kur është marrë aktgjykimi dënues, pavarësisht se a ka marrë formë të prerë apo jo.

Neni 271

“Premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin

(1) Gjykata gjatë procedurës mund të kërkojë nga i pandehuri premtimin se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa lejen e gjykatës kur ekziston dyshim i bazuar se ai ka kryer vepër penale dhe ka arsye për dyshim se i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova.

Premtimi i dhënë shënohet në procesverbal.

(2) Dokumenti i udhëtimit të të pandehurit, i cili detyrohet me premtimin e dhënë nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të konfiskohet përkohësisht. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

(3) Me rastin e dhënies së premtimit, i pandehuri paralajmërohet se ndaj tij mund të caktohet paraburgim po qe se e shkel këtë premtim.”

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

45. Parashtruesi i kërkesës kërkoj nga Gjykata vënien e masës së përkohshme “për ta shmangur diskriminimin e mëtejshëm dhe shkeljen e të drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes me kushtëzimin e cilësdo procedurë penale në vazhdim e sipër”.

46. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi që do ta justifikonte vendosjen e masës së tillë të përkohshme. Ai nuk ka dëshmuar se masa e përkohshme është e domosdoshme për ta shmangur çfarëdo rreziku të dëmit të pariparueshëm apo nëse kërkesa e tillë është në interes publik, siç kërkohej me Nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

47. Prandaj, rezulton që kërkesa duhet të hidhet poshtë.

Pranueshmëria

48. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë.

49. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj,”

dhe Nenit 47.2 të Ligjit, i cili thotë:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

50. Gjykata Kushtetuese rikujton që një kriter i ngjashëm për pranueshmëri është i paraparë në Nenin 35 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”).

51. Sipas praktikës së mirëfilltë gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashtruesit e kërkesës duhet t’i shterin mjetet juridike vendëse që janë në dispozicion dhe efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

më tej pranoi që rregulli i shterjes nuk është as absolut as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike; me rastin e shqyrtimit nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të kihen parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë ndër të tjera se ai duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin ligjor të vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Akdivar kundër Turqisë, të 16 shtatorit 1996.)

52. Për më tepër, në rastet në të cilat mjete juridik i sugjeruar në të vërtetë nuk ofronte gjasa të arsyeshme për sukses, p.sh. nga pikëpamja e praktikës së vendosur gjyqësore vendore, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk e ka shfrytëzuar atë nuk është pengesë për pranueshmëri (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Pressos Compania Naviera S.A. kundër Belgjikës, të 20 nëntorit 1995, para. 27; Radio Franca kundër Francës, nr.. 53984/00, vendimi i 23 shtatorit 2003, para. 33)
53. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, organet administrative janë element i shtetit që e respektojnë sundimin e ligjit, dhe interesat e tyre përkojnë me nevojën për administrim të mirëfilltë të drejtësisë. Në rastet kur organet administrative refuzojnë ose dështojnë ta zbatojnë ligjin, apo vonohen, garancitë që i gëzon një ndërgjyqës gjatë fazës gjyqësore të procedurës nuk kanë kurrfarë kuptimi (shih *mutatis mutandis*, Hornsby kundër Greqisë, aktgjykimi i 19 marsit 1997, *Raportet* 1997-II, f. 511, para. 41).
54. Prandaj, Gjykata Kushtetuese duhet të ketë parasysh cilat mjete juridike vendore ishin në dispozicion dhe efektive për parashtruesin e kërkesës dhe nëse ai i kishte shterur ato.
55. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës pohon që nuk ka mjete juridike vendore në dispozicion dhe efektive që parashtruesi i kërkesës do të mund t'i ushtronte.
56. Palët kundërshtare hollësisht e sqaruan praktikën aktuale gjatë seancës dëgjimore, por asnjëra prej tyre nuk tregoi se ka mjete juridike që janë në dispozicion për situatën e parashtruesit të kërkesës dhe që janë efektive.
57. Në shkresën e 11 majit 2010 të Gjykatës Komunale të Prishtinës u tha qartë që "Gjykata Komunale nuk ka lëshuar asnjë aktvendim të posaçëm për moslëshim të pasaportës, por ajo lëshon aktvendim në rastet kur pasaporta konfiskohet".
58. Në rastin aktual, Gjykata Komunale e Prishtinës vepronte si organ administrativ dhe dështoi t'ia lëshonte parashtruesit të kërkesës certifikatën, e cila, siç thuhet, është dokument i domosdoshëm në mënyrë që MBP të lëshojë pasaportë të Republikës së Kosovës. Kjo praktikë është qartazi e bazuar në memorandumun e sipërpërmendur të mirëkuptimit.
59. Vërtet, Gjykata Komunale konfirmoi në shkresën e 11 majit 2010 se "pasi në rastin aktual [të parashtruesit të kërkesës] nuk është nxjerrë asnjë vendim, nuk ka mundësi për paraqitje të ankesës".
60. Si rrjedhojë, duke marrë parasysh jo vetëm ekzistimin real të mjeteve zyrtare juridike në sistemin ligjor të Kosovës, por edhe kontekstin e saj të përgjithshëm ligjor dhe, në veçanti, praktikën ekzistuese lidhur me lëshimin e pasaportave në Kosovë, Gjykata Kushtetuese mendon që parashtruesi i kërkesës nuk kishte mjete efektive juridike në dispozicion të cilat do të mund t'i ushtronte apo shterte.

61. Prandaj, kërkesa është e pranueshme.

Meritat

i. Për sa i përket të drejtës për liri të lëvizjes

62. Që në fillim duhet të rikujtohet që Neni 53 i Kushtetutës thotë:

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

63. Neni 35 i Kushtetutës thotë:

Neni 35 [Liria e Lëvizjes]

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.

2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.

64. Ngjashëm, Neni 2 i Protokollit Nr. 4 të Konventës thotë:

Liria e lëvizjes

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

2. Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.

3. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

4. Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike.

65. Gjykata Kushtetuese thekson që Neni 2 i Protokollit Nr. 4 të Konventës i garanton çdo personi të drejtën e lirisë së lëvizjes, përfshirë këtu të drejtën për t'u larguar nga vendi dhe për të shkuar në vendin e zgjedhjes së personit në të cilin ai/ajo mund të pranohet. E drejta për t'u larguar nga vendi, përfshirë këtu vendin e vet, duhet të lexohet në përputhje me paragrafin 3 të Nenit 2, i cili parasheh kufizime të caktuara që mund të vendosen në ushtrimin e asaj të drejte në interes, ndër të tjera, të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike.

Testi i zbatueshëm

66. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, testi i zbatueshëm për sa i përket shkëljes së supozuar të së drejtës për t'u larguar nga vendi mund të përmbledhet me sa vijon: për të vepruar në përputhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 4, çdo kufizim duhet të jetë “në përputhje me ligjin”, të ndjekë një apo më shumë qëllime legjitime të parashikuara në paragrafin 3 të të njëjtit Nen dhe të jetë “i domosdoshëm për një shoqëri demokratike” (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Raimondo kundër Italisë, të 22 shkurtit 1994, Seria A nr. 281-A, f. 19, para. 39).
67. Gjykata Kushtetuese vëren që në rastin në fjalë nuk ishte kontestuese që ka pasur ndërhyrje në të drejtën e parashtruesit të kërkesës siç garantohet me Nenin 35 të Kushtetutës dhe Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës, për shkak të moslëshimit të pasaportës.

Nëse kufizimi ka qenë “në përputhje me ligjin”

68. Sa i përket ligjshmërisë së masës, Gjykata tërheq vëmendjen për praktikën e themeluar gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas të cilës shprehja “në përputhje me ligjin” jo vetëm që kërkon që masat e sfiduara të kenë pak bazë ligjore në ligjin vendës, por i referohet edhe cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që të jetë i qasshëm për personin në fjalë dhe i parashikueshëm për sa u përket ndikimeve të tij (shih Rotaru kundër Rumanisë [GC], nr. 28341/95, para. 52, GJEDNJ 2000-V). Në mënyrë që ligji ta përmbushë kriterin e parashikueshmërisë, ai duhet të përcaktojë me mjaft precizitet kushtet në të cilat një masë mund të zbatohet, për t'u mundësuar personave në fjalë – nëse është nevoja me këshilla përkatëse – për ta rregulluar sjelljen e tyre.
69. Gjykata vëren që më 27 prill 2009 parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për lëshimin e pasaportës në Departamentin për Prodhimin e Dokumenteve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës.
70. Në përputhje me Nenin 26 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, Ministria e Punëve të Brendshme ishte e obliguar të vendoste lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për pasaportë brenda 15 ditëve pas 27 prillit 2009. Megjithatë, Ministria dështoi ta bënte këtë.
71. Gjykata më tej vëren që në rastin e parashtruesit të kërkesës, Ministria e Punëve të Brendshme në mënyrë efikase ndalonte lëshimin e pasaportës për parashtruesin e kërkesës pa vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme ose të gjykatës për atë qëllim.
72. Gjithashtu duhet të kihet parasysh që në përputhje me Nenin 27 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, organi kompetent, dmth. Ministria, ka të drejtë ta refuzojë kërkesën për pasaportë “në bazë të vendimit të gjykatës” dhe “nëse gjykata kërkon ndalesën e lëshimit të pasaportës.”
73. Gjykata rikujton që, sipas parashtruesit të kërkesës, kufizimi i vendosur në të drejtën e tij për liri të lëvizjes nuk është i bazuar në ligj, por është çështje e interpretimit të gabuar të ligjeve dhe praktikës në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të 21 gushtit 2008 ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.

74. Gjykata është e kënaqur që ligji në fjalë, d.m.th. Ligji për Dokumentet e Udhëtimit, e plotëson kriterin e qasshmërisë dhe parashikueshmërisë, siç ceket në paragrafin 68 më lart.

Nëse kufizimi ka ndjekur qëllim legjitim

75. Gjykata gjithashtu mendon që vënia e një mase të tillë, si në rastin konkret, për ta siguruar praninë e parashtruesit të kërkesës në procedurën penale të iniciuar kundër tij, ka qëllim legjitim.

Nëse kufizimi ishte “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”

76. Për sa i përket proporcionalitetit të kufizimit të vendosur për shkak të pranisë në procedurë penale, Gjykata rithekson që kjo justifikohet derisa të ekzistojë qëllimi legjitim.
77. Gjykata vëren që praktika e mirëfilltë gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila thekson që një masë e shqiptuar, ndonëse e justifikuar në fillim, mund të bëhet disproporcionale dhe t'i shkelë të drejtat e individit nëse automatikisht zgjatet për një periudhë të gjatë kohore (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Luordo kundër Italisë, nr. 32190/96, para. 96; Földes dhe Földesné Hajlik kundër Hungarisë, nr. 41463/02, para. 35).
78. Në çdo rast, autoritetet janë të obliguara të sigurojnë që shkelja e të drejtës së individit për t'u larguar nga vendi i vet është, prej fillimit e deri në fund të kohëzgjatjes së saj, e justifikuar dhe proporcionale në të gjitha rrethanat. Ato nuk mund t'i zgjasin për periudha të gjata kohore masat që e kufizojnë lirinë e lëvizjes së individit pa rishqyrtim të rregullt të justifikimit të tyre. Shqyrtimi i tillë duhet të kryhet, së paku në instancën e fundit, nga gjykatat, pasi ato ofrojnë garancitë më të mira për pavarësinë, paanësinë dhe ligjshmërinë e procedurave. Përmasa e shqyrtimit nga Gjykata duhet t'i mundësojë t'i marrë parasysh të gjithë faktorët e përfshirë, përfshirë këtu faktorët që kanë të bëjnë me proporcionalitetin e masave kufizuese dhe kalimin e kohës (shih *mutatis mutandis*, aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, 23 qershor 1981, para 60, Seria A nr. 43).
79. Gjykata Kushtetuese vëren që procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës priste të zgjidhej para Gjykatës Komunale të Prishtinës për më tepër se gjashtë vjet dhe që parashtruesi i kërkesës më në fund u lirua.
80. Gjykata Kushtetuese gjithashtu vëren që në procedurën kundër parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale nuk ka lëshuar asnjë vendim në përputhje me Nenin 271 të Kodit të Procedurës Penale. Në vend të kësaj, gjykata u përmbajt për ta lëshuar një certifikatë që ishte sipas praktikës së themeluar kriter i domosdoshëm për lëshimin e pasaportës, ndonëse ky dokument nuk ishte i shënuar në Nenin 23.2 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit.
81. Gjykata mendon që përmasa e procedurës gjyqësore gjithashtu ka dështuar t'i përmbushë kriteret e Nenit 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës.
82. Gjykata është gjithashtu e mendimit që organi administrativ nuk i ka marrë parasysh të gjitha informatat përkatëse për të siguruar që kufizimi i lirisë së lëvizjes së parashtruesit të kërkesës ishte i justifikuar dhe proporcional në dritën e rrethanave të rastit.

83. Sa i përket faktit nëse autoritetet e kanë përmbushur obligimin e vet për t'i rishqyrtuar rregullisht masat të cilat parashtuesit të kërkesës ia kufizojnë lirinë e lëvizjes, Gjykata Kushtetuese vëren që asnjë rishqyrtim i masave të sfiduara nuk ishte bërë.
84. Sa u përket mendimeve të mëparshme, Gjykata Kushtetuese mendon që parashtuesi i kërkesës u ishte nënshtruar masave të një natyre automatike, pa kufizim lidhur me përmasën ose kohëzgjatjen e tyre (shih Riener kundër Bullgarisë, 23 maj 2006, para. 127).
85. Ajo konkludon që autoritetet kanë dështuar në obligimin e tyre sipas Nenit 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës për të siguruar që çdo ndërhyrje në të drejtën e parashtuesit të kërkesës për t'u larguar nga vendi i vet është, prej fillimit e deri në fund të kohëzgjatjes së saj, i justifikuar dhe proporcional në dritën e rrethanave të rastit.
86. Prandaj, ka pasur shkelje të së drejtës së parashtuesit të kërkesës për liri të lëvizjes, të garantuar me Nenin 35 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 2, paragrafin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës.

ii. Për sa i përket të drejtës për mjete efektive juridike

87. Neni 54 i Kushtetutës, i titulluar Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave, thotë:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

88. Neni 13 i Konventës, thotë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

89. Parashtuesi i kërkesës theksoi që nuk ka mjete efektive vendore juridike në dispozicion që do të mund t'i ushtronte.
90. Palët kundërshtarë, siç u cek më lart, sqaruan praktikën aktuale në hollësi, por asnjëra prej tyre nuk tregoi se ka mjete juridike në dispozicion për rastin e parashtuesit të kërkesës dhe se ishin efektive.
91. Gjykata rikujton që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë (në nivel kombëtar) të një mjeti juridik për ta zbatuar substancën e të drejtave dhe lirive të parapara me Konventë, në çfarëdo forme që mund të ndodhin për të qenë i siguruar në rendin ligjor të vendit. Qëllimi i Nenit 13 është të kërkojë sigurimin e një mjeti juridik vendor për ta trajtuar substancën e një “pretendimi të diskutueshëm” sipas Konventës dhe për të ofruar mbrojtje përkatëse juridike.
92. Përmasa e obligimit sipas Nenit 13 të Konventës ndryshon varësisht nga natyra e ankesës së parashtuesit të kërkesës; megjithatë, mbrojtja përkatëse juridike që kërkohet me Nenin 13 duhet të jetë “efektive” në praktikë dhe në ligj. “Efektiviteti” i një “mjeti juridik” brenda kuptimit të Nenit 13 nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për parashtuesin e kërkesës. As “autoriteti” i përmendur në atë dispozitë nuk është medoemos e thënë të jetë autoritet gjyqësor, por nëse nuk është,

kompetencat e tij dhe garancitë që i ofron janë përkatëse për të përcaktuar nëse mjeti juridik para tij është efektiv. Gjithashtu, edhe nëse një mjet i vetëm juridik nuk i kënaq në tërësi kriteret e Nenit 13, tërësia e mjeteve juridike të parapara me ligjin e vendit mund ta bëjë një gjë të tillë (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Silver dhe të tjerët kundër aktgjykimit të Mbretërisë së bashkuar, i 25 marsit 1983, Seria A nr. 61, p. 42, para. 113).

93. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike bazohet në supozimin e pasqyruar në Nenin 13 (me të cilin ka lidhje të ngushtë) se ekziston një mjet efektiv juridik në dispozicion për sa i përket shkeljes së supozuar të të drejtave të individit të parapara me Konventë (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Kudla kundër Polonisë, 26 tetor 2000).
94. Si rrjedhojë, sa herë që ka pretendim të diskutueshëm që një akt i autoriteteve mund ta cenojë të drejtën e individit për t'u larguar nga vendi i vet, të garantuar me Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës, Neni 13 i Konventës kërkon që sistemi ligjor duhet t'ia vërë në dispozicion personit në fjalë mundësinë efektive për ta kundërshtuar masën e shqiptuar dhe t'i shqyrtojë çështjet përkatëse me mbrojtje dhe përpikëri të mjaftueshme procedurale nga një organ përkatës vendor që ofron garanci përkatëse për pavarësi dhe paanësi (shih, *mutatis mutandis*, Shebashov kundër Letonisë (vendim), 9 nëntor 2000, nr. 50065/99 dhe Al-Nashif kundër Bullgarisë, nr. 50963/99, 20 qershor 2002).
95. Nuk ka dyshim që ankesa e parashtruesit të kërkesës sipas Nenit 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës në lidhje me ndalesën efektive kundër largimit të tij nga Kosova ishte e diskutueshme. Prandaj, ai kishte të drejtë për procedurë efektive ankimore sipas ligjit të Kosovës.
96. Gjykata Kushtetuese vëren që palët kundërshtare nënshkruan një memorandum të mirëkuptimit më 21 gusht 2008, me qëllim të themelimit të procedurave dhe përgjegjësi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për zbatimin e Nenit 27 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit.
97. Gjykata thekson që memorandum i vetëm mund ta ndihmojë zbatimin e Ligjit dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përdoret si arsyetim për moszbatimin e Ligjit.
98. Gjykata rikujton që në përputhje me praktikën e bazuar në memorandum, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për pasaportë kurrë nuk ishte shqyrtuar me mbrojtje dhe përpikëri të mjaftueshme procedurale nga një autoritet përkatës.
99. Si rrjedhojë, praktika e bazuar në memorandumin e mirëkuptimit të 21 gushtit 2008, e zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykata Komunale e pengoi parashtruesin e kërkesës që ta gëzonte të drejtën e tij për mjet efektiv juridik në kundërshtim me Nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 13 të Konventës

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në seancën e datës 30 tetor 2010, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDH POSHTË kërkesën për masa të përkohshme;
- II. E SHPALL kërkesën të pranueshme;
- III. KONSIDERON se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për liri të lëvizjes të garantuar me Nenin 35 (2) të Kushtetutës në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. KONSIDERON se praktika e bazuar në memorandumit të 21 gushtit 2008, të zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykata Komunale e pengon parashtruesin e kërkesës që ta gëzojë të drejtën për mjete efektive juridike në kundërshtim me Nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- V. KONSTATON që Ministria e Punëve të Brendshme duhet të vendosë lidhur me kërkesën e parashtruesit, të 27 prillit 2009, për pasaportë në pajtim me Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit brenda 30 ditësh pas pranimi të këtij Aktgjykimi;
- VI. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit;
- VII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë dhe mund t'i bëhet rishikim editorial.

Gjyqtari raportues

Mr.Sc. Kadri Kryeziu, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.